



Prof. dr. Adem Bunguri

Ka lindur me 10 mars 1954 në fshatin Grevë të Peshkopisë. Ka kryer studimet e larta në Universitetin “L. Gurakuqi” të Shkodrës në vitin 1977. Ka punuar për 5.5 vjet në arsim në zonën e Lurës, fillimisht si mësues në shkollën 8 vjeçare Arrën-Mallë (1976-1979) dhe pastaj si drejtor në shkollën 8 vjeçare Gur-Lurë (1979-1981). Bazuar në rezultatet e shkëlqyera të studimeve universitare, përzgjidhet për të vazhduar studimet pasuniversitare për arkeologji në Tiranë.

Gjatë vitit 1982 kryen me rezultate të shkëlqyera kursin e specializimit pasuniversitar të arkeologjisë pranë Qendrës së Kërkimeve Arkeologjike (më vonë Instituti i Arkeologjisë) të Akademisë së Shkencave Tiranë. Që nga viti 1983 punon si arkeolog në Departamentin e Prehistorisë të Institutit Arkeologjik, në vitet 1983-2003 në Bërthamën Arkeologjike të Peshkopisë, ndërsa nga viti 2004 e në vazhdim në Institutin e Arkeologjisë, pjesë e Akademisë së Studimeve Albanologjike, Tiranë.

Në vitet 1984-1986 mbron shkëlqyeshëm të gjitha provimet pasuniversitare në Universitetin e Tiranës, përfshirë edhe atë të gjuhës angleze. Në vitet 1987-1989 kryen gërmimet e para arkeologjike në vendbanimin prehistorik të Topojanit (Dibër) që shërbyen si bazë e përgatitjes së disertacionit të fazës së parë të kualifikimit pasuniversitar.

Në vitin 1991 ka mbrojtur me vlerësimin “shkëlqyeshëm” në Departamentin e Prehistorisë të Institutit të Arkeologjisë disertacionin me temë **“Neoliti dhe Eneoliti në luginën e mesme të Drinit të Zi”** për gradën **“kandidat i shkencave”**. Në vitin 1996 fiton me vlerësimin maksimal titullin **“Doktor i shkencave”**, në vitin 2000 ka fituar titullin **“Prof. assoc. dr.”** ose **“Mjeshtër kërkimesh”** dhe në vitin 2011 ka fituar titullin **“Profesor”** ose **“Drejtues Kërkimesh”**.

Ka drejtuar gërmimet arkeologjike në fushën e arkeologjisë prehistorike në rajonin e Dibrës (1986-2011), ku ka kryer disa fushata gërmimesh sistematike në rajonin e Dibrës, si në vendbanimet prehistorike të Topojanit (1987-1989), të Pesjakës (1991), të Manasdrenit (2002-2003), të Bllaçes (2005), të kalasë së Peshkopisë (2006) dhe të Burimit (2007), si dhe disa gërmime shpëtimi në qendra arkeologjike të këtij rajoni, si në kalanë e Grazhdanit (1983, 2009), kapelën e Pesjakës (1986), varret monumental të Zall-Sinës (1986) dhe të Kurtbegut (1987), në varrezën e dystë të Sofraçanit (2008) etj.

Ka drejtuar sektorë të veçantë të gërmimeve prehistorike në vendbanime prehistorike në rajone të ndryshme të Shqipërisë, si në Podgorie (Korçë 1982), Benjë (Përmet 1983), Zagorë (Shkodër 1987), Konispol (Sarandë 1993), Sovjan (Korçë 1996, 2000, 2001), Grazhdan (1983, 2009) si dhe në nekropolet tumulare të Bujanit (Tropojë 1984, 1986), Myç-Hasit (Kukës 1988). Gjithashtu në vitet e fundit ka drejtuar gërmimet në vendbanimin palafitik të Maliqit (2017), dhe ka bashkëdrejtuar gërmimet në ishullin e Maligradit (2018-2022) etj.

Ka drejtuar kërkimet prehistorike në Kosovë gjatë projektit të përbashkët “*Kërkime Arkeologjike në Kosovë*”(2000-2006), dhe ka bashkëdrejtuar me kolegë të Kosovës gërmimet në vendbanimet prehistorike në Kosovë (2002-2020) si në Hisar (2003-2004, 2007), Vlashnje (2002, 2006-2008, 2010), Korishë (2002, 2006) dhe Reshtan (2010-2011). Gjithashtu ka qenë konsulent shkencor në disa nga gërmimet arkeologjike më të rëndësishme të kryera në Kosovë (2012-2020), si në nekropolet tumulare të Volujakut dhe të Perçevës së Klinës (2012-2013), të Lubozhdës së Istogut (2013, 2015), në gradinat e Budrigës (2015) dhe Cernicës (2016-2017) së Gjilanit si dhe në projektin restaurues të kalasë së Prizrenit (2012-2020) etj. Është bashkëdrejtues i projektit europian mbi dendrokronologjinë e Ballkanit dhe të Egjeut (2018-2022) dhe bashkëdrejtues i projektit kërkimor arkeologjik shqiptaro-grek të Maligradit, Prespë e Madhe (2018-2022) dhe bashkëdrejtues i Projektit bilateral mbi metalurgjinë prehistorike me CNR (Romë) (2019-2022) etj.

Ka dhënë leksione të Arkeologjisë së Përgjithshme në Universitetin “L. Gurakuqi” të Shkodrës (2002-2003), në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Prishtinës (2004-2009) dhe në Universitetin “A. Moisiu” të Durrësit (Programi Master DND) (2010-2011) si dhe ka zhvilluar leksionet e *Arkeologjisë Prehistorike, pjesa II (Epoka e Bronzit dhe e Hekurit)* në Universitetin Shtetëror të Tiranës (2006-2008) si dhe në programin e Shkollës “Master DND”(2009-2014) dhe atë të Shkollës Doktorale (2011-2014) pranë Qendrës së Studimeve Albanologjike (sot Akademia e Studimeve Albanologjike) Tiranë.

Ka botuar dhe përgatitur për botim mbi 70 artikuj shkencorë në revista arkeologjike në Shqipëri, Maqedoni e Veriut, Kosovë, Slloveni, Gjermani Greqi, Poloni dhe Britani. Ka marrë pjesë në disa kongrese ndërkombëtare të Arkeologjisë Prehistorike (Shqipëri, Kosovë, Maqedoni e Veriut, Slloveni, Gjermani, Francë, Greqi, Turqi, Poloni, Itali) etj. Përmendim Konferencën ndërkombëtare *“Dibra dhe Etnokultura e saj”* ku është pjesë e komisionit organizues (Dibër 19-21.11. 1993), Kongresin Ndërkombëtar mbi Neolitit në Ljubljane (07-09.11.2013), International Congress of Albanian Archaeological Studies, Proceedings of the International Congress of Albanian Archaeological Studies, 65-th Anniversary of Albanian Archaeology (21-22 November 2013), Kongresin Ndërkombëtar « L’Illyrie Méridionale et Épire dans L’Antiquité – VI- Actes du V^e colloque international de Tirana (20-23 mai 2015), Konferencën Ndërkombëtare të Prehistorisë "16th International Aegean Conference "ΕΣΠΕΡΟΣ / HESPEROS THE AEGEAN SEEN FROM THE WEST" (Ioannina 18-21 May 2016)", Konferencën I Ndërkombëtare mbi Dendrokronologjinë në Universitetin "N. Kopernik"-Torun (Poloni) (2018), Konferencën Ndërkombëtare mbi 550 vjetorin e vdekjes së Gjergj Kastrioti Skënderbeu në Prishtinë dhe Tiranë (2018), Konferencën Ndërkombëtare mbi arkeologjinë prehistorike në kuadrin e 70 vjetorit të Arkeologjisë, ku është drejtues dhe organizues (Maliq 12-13. 11. 2018), Konferencën Ndërkombëtare në CNR Romë (11-15.12. 2019), Konferencën Ndërkombëtare online mbi Neolitit e Hershëm në Universitetin e Oxfordit 2021 (25-26.06.2021), Kuvendin Ndërkombëtar të Albanologjisë organizuar nga Akademia e Shkencave Tiranë (25-27 Nëntor 2021), Konferencën Kombëtare *“100 vjet nga Lufta e Dibrës”* Tiranë (20.12. 2021), Konferencën Ndërkombëtare *“Genocidi serb kundër shqiptarëve gjatë shek. XIX-XX”* Prishtinë (07-08.04. 2022), *“Third International Conference of Areal Archaeology”* me temë *“Invisible Cities”*. *“A multidisciplinary approach for the study of Albania’s archaeological mining landscape along the Via Egnatia”* (Lecce 18-21.05. 2022). Konferencën II Ndërkombëtare mbi Dendrokronologjinë në Universitetin "N. Kopernik"-Torun (Poloni) me temë *“Second Meeting of Members, Partners and Friends of the Balkan-Aegean Dendrochronology Project”*, Torun (Poland) me temë *“Potential of site Maliq in Albania for development of the tree-ring chronologies”* (Torun 08-11. 06. 2022). Konferencën shkencore Ndërkombëtare *“Archaeology of the Balkans from Prehistory to the end of Antiquity. Recent Discoveries and New Methods”* me temën *“New data on the Bronze Age civilization in Kosovo”*. (Prishtinë 17-19.11. 2022).

Në vitet 2010-2016, ai ka përfituar qëndrime studimore një ose dy muajore në DAI (Deutsches Archaeological Institute) në Frankfurt am Main (Gjermani) dhe DAI në Istanbul (Turqi), për të shfrytëzuar bibliotekat e tyre

shumë të pasura, që kanë përmirësuar ndjeshëm cilësinë e punës së tij shkencore. Gjatë qëndrimeve të tij studimore në DAI Frankfurt am Main, ai ka mbajtur leksione mbi çështje të ndryshme të Arkeologjisë Prehistorike të Shqipërisë dhe të Kosovës. Interesat e tij shkencore janë përqëndruar në studimin e kulturës së epokës së bronzit në Shqipëri dhe në Kosovë, të lidhur ngushtë me proceset e formimit etno-gjenetik të popullsisë ilire në Ballkanin Perëndimor. Kontributi i tij kryesor në këtë fushë studimesh është, pa dyshim, argumentimi shkencor me artikuj, studime dhe prezantime në konferenca ndërkombëtare i hipotezës së tij mbi komponentin anatolian në etogjenezën e ilirëve (2013-2020), në kundërshtim me hipotezën e migracionit "kurgan", që pati mbizotëruar edhe në arkeologjinë shqiptare për afro 60 vjet (1956-2013).

Puna e tij kërkimore në Kosovë, është vlerësuar me medaljen "**Mirënjohje**" nga Komuna Gjakovë (2001) dhe Komuna Suharekë (2012) dhe së fundi me çmimin e lartë për veprimtari jetësore "**Dea Dardanicae**" nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve e Republikës së Kosovës (Prishtinë 2018). Gjithashtu për kontributin e tij studimor, veçanërisht në pjesën që i referohet Dibrës, ai është vlerësuar nga shoqata "Bashkësia Dibrane" (Tiranë) me medaljen "**Mirënjohje**" (2018).

Zotëron shkëlqyeshëm gjuhën angleze dhe ka njohuri të mira në gjuhën gjermane.

Në vitet 2012-2017 zgjidhet anëtar i Senatit Akademik të Qendrës së Studimeve Albanologjike, tani Akademia e Studimeve Albanologjike, ndërsa në vitet 2019-2021 Përgjegjës i Departamentit të Prehistorisë të Institutit të Arkeologjisë dhe Zv/Rektor i Akademisë së Studimeve Albanologjike.

Kësaj CV-je, po i shtojmë edhe vlerësimin zyrtar nga Këshilli Shkencor i Institutit të Arkeologjisë të vitit 2022, në mbështetje të kandidaturës së Prof. Adem Bunguri për në Asamblenë e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë.

Këshilli Shkencor i Institutit të Arkeologjisë, mbështetur edhe në vlerësimet e ardhura nga Departamenti i Prehistorisë, vlerëson se Prof. Adem Bunguri është një nga studiuesit më të përkushtuar dhe produktiv të 10 vjeçarit të fundit në fushën e arkeologjisë prehistorike. Përveç një numri të konsiderueshëm artikujsh shkencor, ai ka botuar gjithashtu edhe disa monografi cilësore mbi kulturat prehistorike në Shqipëri. Në mënyrë të përmbledhur, kontributi i tij në fushën e arkeologjisë prehistorike, mund të përmbledhet në drejtimet e mëposhtme:

- Inkuadrimi i kulturave Neo-Eneolitike të Shqipërisë në grupet dhe komplekset kulturor të Ballkanit dhe atyre të Bronzit të Hershëm dhe të Vonë në arealin Ballkano-Egjean.

- Formulimi dhe argumentimi shkencor për të parën herë i hipotezës së tri modeleve të ndryshme kronologjiko-kulturor të procesit Neolitizimit të Shqipërisë mbi bazën e tre impulseve anatolian të Neolitit të Hershëm.
- Formulimi dhe argumentimi shkencor për të parën herë i hipotezës anatoliane të migracioneve të Bronzit të Hershëm në Shqipëri dhe Kosovë, në kundërshtim me hipotezën e migracionit “kurgan”, që ka mbizotëruar deri vonë në arkeologjinë prehistorike shqiptare. Kjo hipotezë e re, ka përmirësuar ndjeshëm dinamikën e proceseve të formimit të kulturës së Bronzit të Hershëm në Shqipëri, substrati mbi të cilën u zhvilluan më vonë proceset e formimit etnogenetik të popullsisë ilire.
- Hipoteza e zhvillimit të pavarur metalurgjik gjatë Eneolitit dhe Bronzit të Vonë në Shqipëri & Kosovë. Studimi i rolit dhe vendit të metalurgjisë në zhvillimin shoqëror dhe kulturor të bashkësive prehistorike të vendit tonë nga fillimi i Epokës së Eneolitit deri në fundin e asaj të Bronzit.
- Kontributi i rëndësishëm në botimin e plotë të veprës shkencore të Prof. Frano Prendi të përmbledhur në tri vëllime (“*Studime Arkeologjike*” I, “*Archaeological Studies*” II (Prishtinë 2008) dhe “*Vendbanimi prehistorik i Maliqit*”(“*The prehistoric Settlement of Maliq*”)(Tiranë 2018).
- Kontributi i vlerësueshëm në kërkimet dhe studimet arkeologjike në Kosovë (2000-2020), në formimin dhe kualifikimin e një brezi të ri prehistorianësh në Shqipëri dhe Kosovë etj.
- Përditësimi i bazës së të dhënave mbi përkrenaret e tipit ilir në Shqipëri dhe Kosovë dhe përforcimi i hipotezës së Prof. Hasan Ceka mbi atdheun historik të përkrenareve ilire.
- Pasurimi i hartës arkeologjike me qendra të reja, avancimi i metodave bashkëkohore të studimit, mbështetjen e kolegëve dhe brezit të ri të studiuesve, si dhe promovimi i standarteve të larta të botimeve arkeologjike

Në mënyrë të përmbledhur, mund të thuhet se Adem Bunguri është studiues aktiv dhe i suksesshëm në arkeologjinë shqiptare. Vlerësohet për maturinë shkencore dhe për formulimin e përgjithësimeve të rëndësishme lidhur me protogjenezën e shqiptarëve dhe indoeuropianizimin e rajonit. Ka botuar mbi 70 artikuj shkencorë në revista arkeologjike në Shqipëri, Maqedoni e Veriut, Kosovë, Slloveni, Gjermani Greqi, Poloni, Britani (Cambridge, Oksford) dhe SHBA (Harvard University). Ka marrë pjesë në disa kongrese ndërkombëtare të Arkeologjisë Prehistorike (Shqipëri, Kosovë, Maqedoni e

Veriut, Slloveni, Francë, Greqi, Turqi, Gjermani, Poloni, Itali dhe Britani (Cambridge, Oksford) etj.

Ka botuar 6 monografi shkencore mbi prehistorinë e Shqipërisë, 3 si autor i vetëm dhe 3 në bashkëautorësi. Ka në proces botimi 3 monografi shkencore mbi çështje të ndryshme të arkeologjisë prehistorike në Shqipëri dhe Kosovë dhe një monografi divulgative mbi etno-arkeologjinë e Dibrës. Është bashkëautor i vëllimeve I-II të veprës “Harta Arkeologjike e Kosovës” (2006, 2012). Ka përgatitur pët botim me përkujdesje shkencore veprën e plotë të Prof. Frano Prendit në 3 vëllime (2008, 2018) si dhe një monografi të Prof. Selim Islami (2013). Interesat e tij shkencore janë përqëndruar në studimin e kulturës së epokës së Bronzit në Shqipëri dhe në Kosovë, të lidhur ngushtë me proceset e formimit etno-gjenetik të popullsisë ilire në Ballkanin Perëndimor. Ka formuluar dhe argumentuar në pikëpamje shkencore për të parën herë hipotezën anatoliane të migracioneve të Bronzit të Hershëm në Shqipëri dhe Kosovë, në kundërshtim me hipotezën e migracionit kurgan, që ka mbizotëruar deri vonë në arkeologjinë prehistorike shqiptare. Hipoteza e tij ka ndihmuar në njohjen më të mirë të proceseve të formimit të kulturës indo-evropiane të Bronzit të Hershëm në këtë rajon. Është laurat i çmimit të parë “**Dea Dardanicae**” (që jepet nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve e Republikës së Kosovës) në vitin 2018.

Ka udhëhequr një numër të madh mikrotezash të Programeve “Bachelor” dhe “Master Shkencor DND” dhe është udhëheqës shkencor i 3 tezave të doktoraturës. Në vitin 2021 është përzgjedhur nga Komisioni i përhershëm i Historisë dhe Arkeologjisë i Akademisë së Shkencave si autor i tekstit të ri “Historia e Shqiptarëve” (Pjesa e lashtësisë). Mban titullin “**Mjeshtër i Madh**”.



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PRESIDENTI I REPUBLIKËS**

I jep

**ZOTIT ADEM BUNGURI
TITULLIN “MJESHTËR I MADH”**

“Në vlerësim të kontributit të spikatur, si historian e studiues aktiv në shkencën e arkeologjisë shqiptare. I dalluar për studimet kërkimore, botimet e punën hulumtuese në qendrat prehistorike të Shqipërisë, Kosovës, veçanërisht trevës së Dibrës. Zbulimet dhe botimet e tij hedhin dritë mbi të vërtetat arkeologjike dhe parahistorike të gjenezës sonë”.

Nr. Dekreti 13054
Tiranë, më 23.04.2021

PRESIDENTI I REPUBLIKËS



ILIR META

Leksione në Universitete të huaja:

- 30. 04. 2010: ***The Early Bronze Age civilisation in Albania. The “kurgan” or the “anatolian” waves of migrations?.*** DAI (Deutsche Archaeological Instituts), RGK (Römische Germanische Kommission)-**Frankfurt am Main**).
- 19. 11. 2011: ***The Neolithic of Kosova: new excavations and new results.*** DAI (Deutsche Archaeological Instituts), RGK (Römische Germanische Kommission)-**Frankfurt am Main**).
- 27.11. 2012: ***The Early Neolithic in Albania: Three different models of Neolithisation.*** DAI (Deutsche Archaeological Instituts), RGK (Römische Germanische Kommission)-**Frankfurt am Main**).
- 18.10.2013: ***The double Aegean bronze axes in Albania.*** DAI (Deutsche Archaeological Instituts), RGK (Römische Germanische Kommission)-**Frankfurt am Main**).
-
- 11.12. 2014: ***The different kinds of the bronze axes and tools in Albania.*** DAI (Deutsche Archaeological Instituts), RGK (Römische Germanische Kommission)-**Frankfurt am Main**).
- 23.09. 2015: ***The Early prehistoric metallurgy in Albania.*** DAI (Deutsche Archaeological Instituts: Abteilung **Istanbul**).
- 2021: Leksion online në **Heidelberg University** (Deutschland) me temë **“The prehistoric settlement of Maliq (Albania)”**. (Invited by Prof. S. Hansen).
- 2022: **“The potential of Maliq settlement in Albania for development of the tree-ring chronologies”** (Universiteti “N. Kopernik”- Torún, Poland (09. 06.2022).
- 2022: ***A multidisciplinary approach for the Study of Albania’s archaeological mining landscape along the Via Egnatia***. Universiteti i Lecces (19. 05. 2022).

Kongrese & Konferenca Ndërkombëtare:

Ka marrë pjesë në disa kongrese ndërkombëtare të Arkeologjisë Prehistorike:

- **1993:** Organizator, drejtues i seksionit të arkeologjisë dhe anëtar i redaksisë së “International Conference about Dibra ethnology and history (Archaeology section) (Dibër 19-21.11. 1993).
- **2000-2001:** International Conference in Kosova (Prishtina-November 2011-2012)
- **2013 :** International Congress about Early Neolithic: Ljubljana (07-09.11.2013)
- **2013 :** International Congress of Albanian Archaeological Studies. Proceedings of the International Congress of Albanian Archaeological Studies, 65-th Anniversary of Albanian Archaeology (Tirana 21-22 November 2013).
- **2015 :** « L’Illyrie Méridionale et Épire dans L’Antiquité–VI- Actes du Ve colloque international de Tirana (Tirana 20-23 mai 2015).
- **2016:** "16th International Aegean Conference "ΕΣΠΕΡΟΣ /HESPEROS THE AEGEAN SEEN FROM THE WEST". (Ioannina 18-21 May 2016).
- **2017:** International Conference **“New Archaeological Discoveries in the Albanian Regions”**. Academy of Albanian Studies, Institute of Archaeology (Tirana, 30-31 .01. 2017).
- **2018:** International Conference about dendrochronology.In:"N. Kopernik"-University Toruń (Poland) (Toruń qershor 2018).
- **2018:** Konferenca Ndërkombëtare mbi Skënderbeun (Prishtinë 15-16 tetor 2018).
- **2018:** Konferenca Ndërkombëtare mbi Skënderbeun (Tiranë 01-02.11. 2018)
- **2018 :** Organizues dhe drejtues i « **Konferencës Ndërkombëtare Prehistorike** » në kuadrin e 70 Vjetorit të themelimit të Arkeologjisë shqiptare dhe 90 Vjetorit të lindjes së Prof. Frano Prendi (**Maliq 11-12 .11 2018**).
- **2019:** International Conference about archeometallurgy: **“The application of multidisciplinary methods for the investigation of the ancient mining activities in Albania”**. (CNR Roma 11-15.12. 2019).
- **2021: Online International Conference** organised by the University of Oxford, United Kingdom. The subject” **The painted pottery of the Early Neolithic in Albania”**. (25-26.05. 2021).
- **2022:** Konferencë shkencore **“Viti Arkeologjik 2021”**, ku u prezantua **“Maligradi sipas gërmimeve arkeologjike të viteve 2019-2021”** (Tiranë, 15.04. 2022).
- **2022:** Konferencë ndërkombëtare organizuar nga ISPC-CNR dhe Universiteti i Lecces: **“Third International Conference of Areal**

Archaeology” me temë “Invisible Cities”. ”A multidisciplinary approach for the study of Albania’s archaeological mining landscape along the Via Egnatia” (Lecce 18-21.05. 2022).

- **2022: The second International Conference “The Balkan and Aegean Dendrochronology Project tree-Ring. Research for the Study of SE European and East Mediterranean Civilisation”.** Universiteti “N. Kopernik” me temë **“The potential of Maliq settlement in Albania for development of the tree-ring chronologies”** (Torún 08-11.06. 2022).
- 2022: Konferencën shkencore Ndërkombëtare **“Archaeology of the Balkans from Prehistory to the end of Antiquity. Recent Discoveries and New Methods”** me temën **“New data on the Bronze Age civilization in Kosovo”.** (Prishtinë 17-19.11. 2022).

Bibliografia shkencore:

a. Artikuj studimor të botuar para marrjes së titullit “Profesor”:

1. **BUNGURI** Adem, *Gërmimet arkeologjike të vitit 1987-TOPOJAN*, “Iliria”, 1987/2, 237-238.
2. **BUNGURI** Adem, *Gërmimet arkeologjike të vitit 1988 -TOPOJAN* “Iliria”, 1988/2, 246-247.
3. **BUNGURI** Adem, *Gërmimet arkeologjike të vitit 1989-TOPOJAN*, “Iliria”, 1989/2, 262-264.
4. **BUNGURI** Adem, *Armë ilire në krahinën e Dibrës* .“Iliria”, 1989/1,67-73.
5. **BUNGURI** Adem, *Vendbanimi neolitik i Topojanit (Faza Topojan I)*, “Iliria”, 1991, 1-2, 5-27.
6. **BUNGURI** Adem, *Gjetje nga varreza e Gjoricës së Poshtme (Rrethi i Dibrës)* “Iliria”, 1992, 1-2, 301-312.
7. **BUNGURI** Adem, *Vendbanimi neolitik i Topojanit (Faza Topojan II)*, “Iliria”, 1993/1-2, 33-94.
8. **BUNGURI** Adem, *Vendbanimi ilir i Pesjakës (Dibër)*, “Iliria”, 1994/1-2, 87-97.
9. **BUNGURI** Adem² - **KORKUTI** Muzafer,¹ *Kultura e epokës së bronzit në vendbanimin e Cetushit*. "Iliria", 1996/1-2, 5-19.
10. **BUNGURI** Adem, *Periudhat postneolitike të vendbanimit të Topojanit*:- "Iliria", 1997/ 1-257-84..
11. **BUNGURI** Adem, *Aspekte të zhvillimit prehistorik në pellgun e Dibrës në dritën e zbulimeve të reja arkeologjike*, “Dibra dhe etnokultura e saj”, (Dibër 19-21 .11. 1993), vol. I, Dibër 1995, 24-31.
12. **BUNGURI** Adem, *Mbi urbanizimin antik dhe të mesjetës në krahinën e Dibrës*, « Dibra dhe etnokultura e saj », (Dibër 19-21 .11. 1993), vol. I, Dibër 1995, 44-53.
13. **BUNGURI** Adem, *Mardhënjet ekomomiko-kulturore midis dy Dibrave*, Dibër e Madhe, 13-14 prill 2000.
14. **BUNGURI** Adem, *Edhe njëherë mbi kalanë e Sfetigradit*, Simpoziumi i 600 vjetorit të lindjes së Skënderbeut, Dibër e Madhe, 18.11. 2005.
15. **BUNGURI** Adem-**GASHI** Shafi, *Të dhëna të reja mbi kronologjinë e Hisarit*, Simpoziumi historik, Suharekë 25.11. 2005.
16. **BUNGURI** Adem-**GASHI**, Shafi, *Të dhëna të reja mbi kronologjinë e Hisarit*, "Kosova Arkeologjike", I, 2005, Prishtinë 2006, 11-20.
17. **BUNGURI** ADEM, *Kapela e Pesjakes (Dibër)*, „Candavia“ 2, 2005, 381-386.
15. **BUNGURI** Adem⁴- PËRZHITA Luan¹-LUCI Kemajl²-HOXHA Gëzim³-PEJA Fatmir⁵- KASTRATI Tomor⁶, « Harta Arkeologjike e Kosovës », I, Prishtinë 2006.

18. BUNGURI Adem, *Pellgu i Drinit të Bardhë në prehistori (shqip+anglisht)*, « **Harta Arkeologjike e Kosovës** », I, Prishtinë 2006, 27-55.
19. BUNGURI Adem¹-LUCI-Kemaj²-KASTRATI Tomor³, *Qendra prehistorike*, « **Harta Arkeologjike e Kosovës** », I, Prishtinë 2006, 57-127.
20. BUNGURI, Adem, *Tipare të qytetërimit neo-eneolitik në Rrafshin e Dukagjinit (Kosovë)*, « Vepra themelore në Albanologji », Aktet e Konferencës Shkencore Ndërkombëtare(18-20.12. 2008), Tiranë 2009, **301-315**.
21. BUNGURI Adem⁴-PËRZHITA Luan¹-LUCI Kemaj²-HOXHA Gëzim³-PEJA Fatmir⁵-KASTRATI Tomor⁶, *Përnjohje arkeologjike në Kosovë (2000-2005)*, « Vepra themelore në Albanologji », Aktet e Konferencës Shkencore Ndërkombëtare(18-20.12. 2008), Tiranë 2009, **289-300**.
22. BUNGURI Adem, *Gjetje nga kalaja e Grazhdanit, "Monumentet"* 2007, **100-121**.
23. BUNGURI Adem, *Dy varre monumentale në rajonin e Dibrës, "Monumentet"* 2008, **117-131**.
24. BUNGURI Adem, *Frano Prendi-një jetë për arkeologjinë (Frano Prendi-a life in Archaeology)*, « **Iliria** » XXXIII, 2007-2008, **12-25**.
25. BUNGURI Adem, *Kalaja e Koxhaxhikut (Dibër), "Studime Historike"*, 2009/1-2, **27-56**.
26. BUNGURI Adem, *Të dhëna të reja mbi Neolitin dhe Eneolitin në Kosovë, "Iliria"* XXXIII, 2007-2008, **47-82**.

b. Artikuj studimor të botuar dhe të përgatitur për botim pas marrjes së titullit "Profesor":

1. BUNGURI Adem, *Të dhëna arkeologjike nga Çidhna e Poshtme (Dibër), "Candavia"*, 3, 2011, **197-219**.
2. BUNGURI Adem²-PËRZHITA Luan¹-LUCI Kemal³-KOÇBASHLLIU Luan⁴, *Gjetje të hershme mesjetare në Banjë të Malishevës (Raport paraprak i gërmimeve arkeologjike të vitit 2007)*, « **Candavia** » 3, 2011, **363-371**.

3. BUNGURI Adem, **Prof. Frano Simon Prendi (1928-2011), Një jetë kushtuar arkeologjisë- In Memoriam**, « **Hylli i Dritës** », 2012, nr. 1, Shkodër 2012, **72-91**.
4. BUNGURI Adem-GASHI Shafi, **Vlashnje (Prizren), "Iliria"** XXXIV, 2009-2010, **388-389**.
5. BUNGURI A-VALLA M-KOÇBASHLLIU L-GASHI Sh, **Harta Arkeologjike e Komunës Drenas (Gllogoc)**. In: « **HARTA ARKEOLOGJIKE E KOSOVËS** », II, (Red. Enver Rexha), Prishtinë 2012, 120-145.
8. BUNGURI Adem, **Të dhëna të reja mbi periudhën e vonë romake, atë të vonë antike dhe mesjetare në rajonin e Dibrës**, "Candavia" 4, 2014, **163-191**.
9. BUNGURI Adem, **Helmets from Sofraçan, "Recent Archaeological Discoveries in Albania" Album** (1998-2013) (eds. L. Përzhita-I. Gjipali-B. Muka), Tirana 2013, **68-71**.
10. BUNGURI Adem, **Some aspects of the Early Bronze Age in Albania and Kosovo**. "International Congress of Albanian Archaeological Studies», Proceedings of the International Congress of Albanian Archaeological Studies, 65th Anniversary of Albanian Archaeology (21-22 November 2013), Tirana 2014, **121-140**.
11. BUNGURI Adem, **Different models for the Neolithisation of Albania**, « **Documentae Praehistoricae** », XLI, Ljubljana 2014, **79-94**.
12. BUNGURI Adem-GASHI Shafi, **The Culture of Bronze Age in Kosovo in the light of recent excavations**. In: « **L'Illyrie Méridionale et Épire dans L'Antiquité-VI** »- Actes du Ve colloque international de Tirana (20-23 mai 2015). vol. I)(eds. J.L. Lamboley-L. Përzhita-A. Skënderaj), Tirana 2018, **33-56**.
13. BUNGURI Adem, **Relations between Mycenaean world and Albania during Middle and Late Helladic (as reflected from imported Mycenaean weapons and tools)** In: 16th "INTERNATIONAL AEGEAN CONFERENCE ΕΣΠΕΡΟΣ / HESPEROS THE AEGEAN SEEN FROM THE WEST", (Ioannina 18-21 May 2016). AEGEUM 41, "HESPEROS", Liège 2017, **305-317/328**.
14. BUNGURI Adem, **Kërkime të reja mbi gjenezën e kulturës së Bronzit të Hershëm në Shqipëri dhe Kosovë**, "Iliria" XXXIX, Tiranë 2015, **25-74**.

15. BUNGURI Adem, ***Models and ways of the Neolithisation of Albania.*** International conference "***New archaeological discoveries in the Albanian regions***" (Tirana 30-31 janar 2017), Tiranë 2017, vol. I, **67-103.**
16. BUNGURI Adem, ***Të dhëna të reja mbi neolitizimin në territorin e Shqipërisë***, "***Iliria***" XLI, Tiranë 2017, **7-69.**
17. BUNGURI Adem, ***"Vendbanimi ilir i Pesjakës" (pjesa II), "Candavia" 7,*** Tiranë 2018, **7-65.**
18. BUNGURI Adem, ***"Another look at the "Kurgan" migration hypothesis according to archaeological evidence from Albania and Kosovo"***, "***ALBANIAN STUDIES***" nr.1, 2019, Tiranë 2019, **7-75.**
19. BUNGURI Adem, ***"Double bronze axes in Albania"***, "***ALBANIAN STUDIES***", nr.2, 2019, Tiranë 2019, **7-55.**
20. BUNGURI Adem, ***Përkrenare ilire nga Sofraçani.*** "***Iliria***" XLII, Tiranë 2019, 57-97.
21. BUNGURI Adem, ***Një stemë guri e Gropajve në Maqellarë të Dibrës së Epërme.*** "***Iliria***" XLII, Tiranë 2019, **23-33.**
22. BUNGURI Adem, ***Të dhëna arkeologjike mbi Kullën e Skënderbeut në Vajkal të Bulqizës (Dibër).*** In: "Aranitët në Librazhd" (botim i Akademisë së Studimeve Albanologjike dhe shoqatës kulturore "Çermenika 2017"). (Përgatiti për botim A. Alcani. Reçensa: P. Xhufi-A. Bunguri), **Tiranë 2019, 33-59.**
23. BUNGURI Adem, ***Kontributi i arkeologjisë në identifikimin e fortifikimeve të periudhës së Skënderbeut në rajonin e Dibrës,*** "***Studime Historike***" 2019/1-2, Tiranë **2019, 205-253.**
24. BUNGURI Adem, ***Të dhëna arkeologjike mbi disa fortifikime të periudhës së Skënderbeut në rajonin e Dibrës.***"Gjergj Kastrioti-Skënderbeu" në 550 vjetorin e vdekjes. Materiale nga Konferenca shkencore ndërkombëtare "Gjergj Kastrioti-Skënderbeu në 550 vjetorin e vdekjes", Prishtinë,16.10.2018), Instituti i Historisë "Ali Hadri", **Prishtinë 2019, 155-219.**
25. BUNGURI Adem, ***Problems of Neolithisation in Albania.*** In: J. Kozłowski-M. Kaczanowska (eds) "***Neolithization between Adriatic and the Black Sea.***" "***EURASIAN PREHISTORY***", vol. 15, nr.1-2. "***American School of Prehistoric Research. Harvard University***", Cambridge 2019, **47-100.**

26. BUNGURI Adem, ***Një gotë qelqi veneciane nga kështjella e Peshkopisë, "Iliria"*** XLIII, Tiranë 2020, **229-237**.
27. BUNGURI Adem¹-LERA Petrika²-OIKONOMIDHIS Stavros³-PAPAJANNIS Aris⁴- TSONOS Akis⁵, me kontributin e Panajotis KAPLANIS dhe Nikos KARAJANNIS. ***Ekspedita arkeologjike greko-shqiptare në ishullin e Maligradit (Prespa e Madhe) (Rezultate paraprake), "Candavia"*** 8, 2020, 445-465.
28. **BUNGURI Adem**¹-LERA Petrika²-OIKONOMIDHIS Stavros³-PAPAJANNIS Aris⁴-TSONOS Akis⁵, with contribution by Nevenka ATANASOSKA, ***Towards an archaeology of the lakes: the distribution of the Prespan sites from Prehistory to Late Antiquity.*** "Iliria" XLIV, Tiranë 2021, **131-191**.
29. **BUNGURI Adem**, In Memoriam: "Prof. Dr. Frano Prendi-Një nga themeluesit e arkeologjisë shqiptare". "Iliria" XLIV, Tiranë 2021, **419-432**.
30. BUNGURI Adem, ***Archaeological data on some fortifications of Scanderbeg's period in Dibra's region.*** "Studia Albanica", 2019/2, **147-204**.
31. BUNGURI Adem, ***New data on the Neolithisation in the territory of Albania*** "ALBANIAN STUDIES", 1, 2021, **7-75**.
32. BUNGURI Adem, ***Të dhëna të reja mbi vendbanimin prehistorik të Maliqit.*** "Iliria" XLV, Tiranë 2022, **103-117**.
- 33.** BUNGURI Adem¹-LERA Petrika²-OIKONOMIDHIS Stavros³-PAPAJANNIS Aris⁴-TSONOS Akis⁵, ***"Identifiable Records and Identities at Prespa"***. In: Colloque international d'archéologie Organisé par l'ambassade de France en Albanie, l'Institut archéologique de Tirana et l'UMR 8546-AOrOc. ILLYRIES IDENTITES CROISEES. Avec le soutien des ambassades de Grèce et de Suisse Dans le cadre du mois de la francophonie 2020 à Tirana, 3-4 mars 2020. (in print).
34. Bunguri Adem, ***Illyrian helmet from Sofraçan (Dibër).*** "Studia Albanica" 2021/1. (in print).
35. Bunguri Adem, ***"Monography "Studies in the Prehistory of Albania".*** "Studia Albanica" 2021/1. (in print).

36. BUNGURI Adem, ***A stone coat of arms of Gropaj in Maqellara of the Upper Dibra. "Studia Albanica"*** 2021/2. (in print).
37. BUNGURI Adem¹-GAUß Roland²-RUMMEL Christoph³), ***Mbi prospeksionin gjeomagnetik të disa vendbanimeve prehistorike dhe antike të vona në Shqipëri/ Report on the geomagnetic prospectations in some prehistorical and antique sites in Albania.*** (Institute of Archaeology, Tirana and the Roman Germanic Commission of the Deutsche Archaeological Institute (Frankfurt am Main) **"Candavia"** IX, 2021. (in print).
38. BUNGURI Adem, ***Të dhëna të reja mbi Eneolitin dhe Bronzin e Hershëm në rajonin e Dibrës, "Iliria"*** XLV, 2022. (in print).
41. BUNGURI Adem¹-LELA Surja², ***Vendbanimi i epokës së Bronzit në Manasdren (Qafë-Murrë/Dibër), "Iliria"*** XLV, Tiranë 2022. (in print).
39. BUNGURI Adem, ***New aspects of the neolithisation of Albania, "Studia Albanica", 2021/2.*** (in print).
40. BUNGURI Adem, ***New data about the Neolithisation process in Albania. "International Conference on Neolithic Civilisation"*** (Oxford 25-26.05. 2021). (in print).
41. BUNGURI Adem, ***Rivlerësimi i hipotezës së migracionit "kurgan" sipas evidencës arkeologjike nga Shqipëria dhe Kosova.*** "Kuvendi Ndërkombëtar i Albanologjisë" (organizuar nga Akademia e Shkencave e Shqipërisë) (Tiranë 25-27.11. 2021). Aktet e Kuvendit Albanologjik. (in print).

C. Monografi:

C₁. Disertacion :

BUNGURI Adem, **"NEOLITI DHE ENEOLITI NË LUGINËN E MESME TË DRINIT TË ZI"** (***Disertation***) Biblioteka e Institutit të Arkeologjisë (**sigla: 0042-47**), **"Biblioteka Kombëtare e Shqipërisë"** (**sigla: 05-11/13F**), Tiranë 1992. Formati A₄ (30 x 20 cm), **190 faqe**, 14 figura, 63 tabela ilustruese).

C₂: Monografi të botuara:

1. PRENDI Frano¹-BUNGURI Adem², «**BRONZI I HERSHËM NË SHQIPËRI** » («**THE EARLY BRONZE AGE IN ALBANIA** »)(shqip-english). Botim i Institutit të Arkeologjisë Tiranë dhe Qendrës së Studimeve Albanologjike, **Prishtinë 2008. ISBN : 978-9951-555-00-5**. Formatimi B₅ (24 x 17.5 cm), Shkrim TNR 11, spacio 1.15, **346 faqe** (176 faqe shqip, 158 faqe english), **43 figura, 64 tabela ilustruese**). Sponsor i botimit: Dr. Shafi GASHI (Prizren).

2. BUNGURI Adem, «**PREHISTORIA E DIBRËS**», Botim i Institutit të Arkeologjisë dhe Qendrës së Studimeve Albanologjike, **Tiranë 2010. ISBN : 978-99956-04-51-6**. Formatimi A₄ (30 x 20 cm), shkrim BMS 12, spacio 1.15, **327 faqe, 71 figura, 122 tabela ilustruese**), 806 fussnota, 241 tituj bibliografik. English summary. Sponsor i botimit: Dr. Shafi GASHI (Prizren).

3. PRENDI Frano¹-BUNGURI Adem², «**STUDIME PËR PREHISTORINË E SHQIPËRISË** », Botim i Institutit të Arkeologjisë dhe Qendrës së Studimeve Albanologjike, **Tiranë 2014. ISBN : 978-9928-172-18-1**. Formatimi B₅ (24x17.5cm) Shkrim TNR 11, spacio 1.15, **415 faqe, 78 figura**, planimetri, diagrama, **173 tabela ilustruese**, dy tabela sinkronike të Paleolit-Mezolitit dhe Neolit-Eneolitit, 6 tabela tipologjike të enëve sipas periudhave historiko-kulturore dhe 13 tabela të appendiksit informativ, 1483 fussnota, 412 tituj bibliografik. Sponsor i botimit: Dr. Shafi GASHI (Prizren).

4. PRENDI Frano¹-BUNGURI Adem², «**STUDIES IN THE PREHISTORY OF ALBANIA** », Botim i Institutit të Arkeologjisë dhe Akademisë së Studimeve Albanologjike, **Tiranë 2018. ISBN: 978-9928-256-48-5**. Është version English i monografisë “Studime për Prehistorinë e Shqipërisë” me shtesën e informacionit të ri arkeologjik të viteve 2014-2018. Formatimi B₅ (24x17.5cm). Shkrim TNR 11, spacio 1.15, **582 faqe**, e gjitha në english, **95 figura**, planimetri, diagrama, **174 tabela ilustruese**, dy tabela sinkronike të Paleolit-Mezolitit dhe Neolit-Eneolitit,

6 tabela tipologjike të enëve sipas periudhave historiko-kulturore dhe 16 tabela të appendiksit informativ, 1420 fussnota, 453 tituj bibliografik. Sponsor i botimit: Dr. Shafi GASHI (Prizren).

5. BUNGURI Adem, "**VEGLA BAKRI DHE SËPATA BRONZI NË SHQIPËRI DHE KOSOVË**" (**THE COPPER TOOLS AND BRONZE AXES IN ALBANIA AND KOSOVO**). Botim i Akademisë së Studimeve Albanologjike. **Tiranë 2021**. ISBN: 978-9928-289-58-2. Formatimi A4 (21 x 29 cm), **404 faqe**, 27 figura, 77 tabela ilustruese. English summary.

6. BUNGURI Adem "**PËRKRENARE ILIRE NË SHQIPËRI DHE KOSOVË**". Botim i Institutit të Arkeologjisë të Shqipërisë dhe Institutit Arkeologjik të Kosovës. Tiranë **2022**. ISBN **978-9928-387-21-9**. Formatimi B₅ (24x17.5cm), **292 faqe**, **24 figura**, **diagrama**, **hartat**, **76 tabela ilustruese**.

C₃: Monografi në proces pune:

1. BUNGURI Adem, "**NEOLITI I HERSHËM NË SHQIPËRI**" (**THE EARLY NEOLITHIC IN ALBANIA**) (shqip-english) Botim i Institutit të Arkeologjisë dhe Akademisë së Studimeve Albanologjike. **Tiranë 2023**. ISBN_____Formatimi B₅ (24 x 17.5 cm), **232 faqe**, **35 hartat**, diagrama, grafike, plane, profile etj; **64** tabela ilustruese, 5 tabela informative, 2 tabela kronologjike).
2. BUNGURI Adem, « Arkeologjia e Dibrës» **Tiranë 2023**. ISBN_____Formatimi B₅ (24 x 17.5 cm), **342 faqe**, **75** figura, **125** tabela ilustruese.
3. BUNGURI Adem¹-GASHI Shafi², "**PREHISTORIA E KOSOVËS**" (**THE PREHISTORY OF KOSOVO**). Botim i Institutit të Arkeologjisë të Shqipërisë dhe Institutit Arkeologjik të Kosovës. **Prishtinë 2023**. ISBN_____.Formatimi A₄ (21 x 29 cm), **265 faqe**, **45** figura; **65** tabela ilustruese. Sponsor i botimit: Dr. Shafi GASHI (Prizren).

d. Editime & botime: BUNGURI-Adem-GASHI Shafi:

1. PRENDI Frano, "STUDIME ARKEOLOGJIKE", I (Përmbledhje artikujsh në gjuhën shqipe). Botim i Institutit të Arkeologjisë dhe Qendrës së Studimeve Albanologjike, **Prishtinë 2008. ISBN: 978-9951-555-01-2**. Formatimi B₅ (24 x 17.5 cm), **895 faqe**. Shkrim TNR 11, spacio 1, 143 figura, planimetri, diagrama, 210 tabela ilustruese, 1450 fushnota. Botues : A. Bunguri-Sh. Gashi. Sponsor i botimit: Dr. Shafi GASHI (Prizren).

2. PRENDI Frano, "ARCHAEOLOGICAL STUDIES", II (Përmbledhje artikujsh në gjuhë të huaja). Botim i Institutit të Arkeologjisë dhe Qendrës së Studimeve Albanologjike, **Prishtinë 2008. ISBN: 978-9951-555-02-9**. Formatimi B₅ (24 x 17.5 cm), **751 faqe**. Shkrim TNR 11, spacio 1, 240 figura, planimetri, diagrama, 214 tabela ilustruese, 1026 fushnota. Botues : A. Bunguri-Sh. Gashi. Sponsor i botimit: Dr. Shafi GASHI (Prizren).

3. ISLAMI Selim, "KULTURA ILIRE E TUMAVE TË MATIT". Botim i Institutit të Arkeologjisë Tiranë dhe Institutit Arkeologjik Prishtinë, **Prishtinë 2013. ISBN : 978-9951-604-00-0**. Formatimi B₅ (24 x 17.5 cm) **161 faqe**. Shkrim TNR 11, spacio 1.15, 33 figura, planimetri, diagrama, 60 tabela ilustruese, 71 fushnota, 55 tituj bibliografik, English summary. Botues : A. Bunguri-Sh. Gashi. Sponsor i botimit: Dr. Shafi GASHI (Prizren).

4. PRENDI Frano, "VENDBANIMI PREHISTORIK I MALIQIT" ("THE PREHISTORIC SETTLEMENT OF MALIQ"), **Tiranë 2018, ISBN: 978-9928256-49-2**. Formatimi B₅ (21 x 17.5 cm) Shkrimi Adob Calson 11, 1.15 spacio, **504 faqe, (160 faqe shqip, 145 faqe English)**, 21 planimetri, diagrama, 178 tabela ilustruese, 426 fushnota, 141 tituj bibliografik. Botues : A. Bunguri-Sh. Gashi. Sponsor i botimit: Dr. Shafi GASHI (Prizren).

e. Botime me grup autorësh:

e1. HARTA ARKEOLOGJIKE E KOSOVËS, I, II

1. **BUNGURI Adem**⁴-PËRZHITA Luan¹-LUCI Kemajl²-HOXHA Gëzim³-PEJA Fatmir⁵-KASTRATI Tomor⁶, « **HARTA ARKEOLOGJIKE E KOSOVËS** », **I, (ARCHAEOLOGICAL MAP OF KOSOVO, I)** (grup autorësh) Botim i Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës dhe Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, **Prishtinë 2006. ISBN : 978-9951-413-59-6.** Formatimi A4 (30 x 20 cm), **394 faqe.** 282 figura, 27 tabela ilustruese).

2. **BUNGURI Adem**¹-KOÇBASHLLIU Luan²-VALLA Masar³-GASHI Shafi⁴, **HARTA ARKEOLOGJIKE E KOMUNËS DRENAS (GLLOGOC).** In: « **HARTA ARKEOLOGJIKE E KOSOVËS** », **II, (ARCHAEOLOGICAL MAP OF KOSOVO, II) Prishtinë 2012, 120-145.** Botim i Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe Institutit Arkeologjik të Kosovës (Red. Enver Rexha). **Prishtinë 2012. ISBN: 978-9951-604-01-7.** Formatimi A4 (30 x 20 cm), **332 faqe,** 211 figura, 24 tabela ilustruese).

e2. Albume dhe Katalogë (grup autorësh):

1. **“Katalog Arkeologjik i Kosovës”**, Botim i Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporteve dhe Muzeumit të Kosovës (Red. Përgjegjës: Sh. Gashi), Prishtinë 2013.
2. Album **"Recent Archaeological Discoveries in Albania"** (1998-2013) (eds. L. Përzhita-I. Gjipali-B. Muka), Tiranë 2013.